



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2486 prot.

Shkodër, më 10.08.2021

V E N D I M

Nr. 261, datë 10.08.2021

"Për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit "Histori dhe trashëgimi kulturore"


Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 74 pika 2, Statutin e USH-së neni 17, pika 6, gërma "o", Neni 53, Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim propozimin e sjellë nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2021

Vendosi:

1. Miratimin e kriterëve për kandidatët konkurues që aplikojnë për të ndjekur studimet me kohë të plotë pranë USH-së për vitin akademik 2021-2022(materiali bashkangjitur) për programin "Histori dhe trashëgimi kulturore".
2. Ky vendim t'i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARE
Prof. dr. Suzana GOLEMI

Jr: 24.06 prot
dt: 30.07.2021

Z. Rektore
S. Kelle




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "Luigj Gurakuqi"
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

DEKANI

Nr. 268 prot.

Shkodër, më 30.7.2021

Lënda: **Kriteret e degës bachelor "Histori dhe trashëgimi kulturore"**

Prof.dr. Suzana GOLEMI
Rektore së Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi",

Bashkëngjitur kësaj shkrese po ju dërgojmë vendimin e departamentit të Historisë
dega bachelor "Histori dhe trashëgimi kulturore".

DEKANI
Prof. dr. Artan Golemi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave Shoqërore
Departamenti i Historisë

Shkodër, më 30.07.2021

Lënda: VENDIM mbi kriteret e pranimit dhe kuotat e studentëve për vitin akademik 2022-2023 në programin e ri të studimit Bachelor në "Histori dhe trashëgimi kulturore"

Drejtuar: DEKANIT të Fakultetit të Shkencave Shoqërore

Departamenti i Historisë në kuadër të miratimit të programit të ri të studimit Bachelor në "Histori dhe trashëgimi kulturore", në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve në studimet e ciklit të parë të studimeve për vitin akademik 2022-2023, bazuar në sugjerimet e stafit të brendshëm akademik, përvojat e mëparshme dhe dinamikës së kurrikulës së arsimit të mesëm, vendosi të paraqesë formulën e pranimit të studentëve për këtë vit akademik si më poshtë:

70 % Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet e studimit në arsimin e mesëm (llogaritur sipas VKM-së Nr. 436 dt. 3.06.2020, i ndryshuar)
30 % Nota mesatare e provimeve të Maturës Shtetërore

Mundësia e pranimit të studentëve në këtë program studimi që ofron Departamenti i Historisë në vitin akademik 2021-2022, është 50 kuota (+ 10 kuota për aplikantë nga trojet jashtë kufijve).

Drejtoresha e Departamentit

Prof. Dr. Neritilla Haxhila Ljarja